



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

PRISHTINA



Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina

01-970

Në bazë të nenit 21, 22 dhe 44 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 20/21 qershor 2016), nenit 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 18/03 korrik 2012), nenit 17 pika “d” e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 dt. 20.02.2008 nenit 15 pika “d” e Statutit të Komunës së Prishtinës Nr.110-391 dt. 25.02.2010, dispozitive të nenit 12 të Udhëzimit Administrativ nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit, dhe duke vendosur sipas kërkesës 05 Nr. 391/02-127693/22 dt. 06.06.2022, investitorit “Tregtia” sh.p.k. me adresë rr. “Fazli Fetahu” në Prishtinë me certifikatë të biznesit me nr. 80026897, me përfaqësues Bedri Prishtina nga Prishtina, për lëshimin e certifikatës së përdorimit, të kompleksit me ndërtesa shumë banesore me afarizëm, përkatësisht Ndërtesa “R9/01” me etazhitet -4B+P+7, Ndërtesa “R9/02” me etazhitet -4B+P+10, Ndërtesa “R9/07” me etazhitet -2B+P+10, Ndërtesa “R9/08” me etazhitet -2B+P+6 dhe garazha “G1/G2” Bodrumi -3 & “G1/G2” Bodrumi -4, të ndërtuara në kuadër të Planit Rregullues të Hollësishëm për blloqet B17, B18, B19, dhe B20 - Lagjja “Mati 1” 2017-2015, Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, në procedurë të rregullt administrative, me datën 06.03.2023 lëshon këtë:

CERTIFIKATË E PËRDORIMIT

I. I LËSHOHET Certifikata e përdorimit investitorit “Tregtia” sh.p.k. rr. “Fazli Fetahu” në Prishtinë me certifikatë të biznesit me nr. 80026897, me përfaqësues Bedri Prishtina nga Prishtina, sipas kërkesës 05 Nr. 391/02-127693/22 dt. 06.06.2022, për përdorimin e ndërtesave shumë banesore me afarizëm, përkatësisht Ndërtesa “R9/01” me etazhitet -4B+P+7, Ndërtesa “R9/02” me etazhitet -4B+P+10, Ndërtesa “R9/07” me etazhitet -2B+P+10, Ndërtesa “R9/08” me etazhitet -2B+P+6 dhe garazha “G1/G2” Bodrumi -3 & “G1/G2” Bodrumi -4, të ndërtuara në kuadër të Planit Rregullues të Hollësishëm për blloqet B17, B18, B19, dhe B20 – Lagjja “Mati 1” 2017-2015, konkretisht në parcelën nr. 1608-3, ZK Matičan, sipas Vendimit 05Nr.351/02-0208312/17 dt. 06.02.2018 për lejimin e ndërtimit të ndërtesave.

II. Ndërtesat, mund të përdoren, sipas destinimit të përcaktuar në pikën I. të Vendimit të Lejes Ndërtimore 05Nr.351/02-0208312/17 dt. 06.02.2018, dokumentacionit ndërtimor dhe Inspektimit Final të lëshuar nga Drejtoria e Inspektionit të Komunës së Prishtinës Sektori i Ndërtimit.

III. Ndërtesat gjinden: Rr. “Beteja e Loxhës” me nr. e hyrjes/daljes 29, 31, 33, 35, 37, 39, 41, Rr. “Çuka” me nr. e hyrjes/daljes 26, 28, 30, 34, 36, 38, 40, dhe Rr. “Lavdie Lusha” me nr. e hyrjes/daljes 2, 4, 6, 8, 10, 12, 14.

IV. Ndërtesat mund të përdoren nga dita e marrjes në dorëzim të kësaj Certificate.

V. Kjo Certificate shërben për regjistrimin e ndërtesave në regjistrin kadastral të përshkruar në pikën I. të këtij vendimi.

VI. Pjesë përbërëse e këtij vendimi të certifikatës së përdorimit është dokumentacioni sipas shtojca 5 e Udhëzimit Administrativ MMPH. Nr. 05/2017 për Mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit.

Arsyetim

Investitori “Tregtia” sh.p.k. me seli në Prishtinë me certifikatë të biznesit me nr. 80026897, me përfaqësues Bedri Prishtina nga Prishtina, me kërkesën 05 Nr. 391/02-127693/22 dt. 06.06.2022, kan kërkuar nga kjo drejtori, lëshimin e certifikatës së përdorimit të ndërtesave shumë banesore me afarizëm, Ndërtesa “R9/01” me etazhitet -4B+P+7, Ndërtesa “R9/02” me etazhitet -4B+P+10, Ndërtesa “R9/07” me etazhitet -2B+P+10, Ndërtesa “R9/08” me etazhitet -2B+P+6 dhe garazha “G1/G2” Bodrumi -3 & “G1/G2” Bodrumi -4, në lokacionin e përshkruar si në pikën I. të dispozitivit të kësaj certificate.

Drejtoria e Inspektionit-Sektori i Ndërtimit i Komunës së Prishtinës përmes shkresës zyrtare “Njoftim mbi inspektimin final me referencë 09 Nr. 391/02-228921/21 dhe 09 Nr. 391/02-228921/21/1 dt. 11.05.2022 ka përcjellë në Drejtorinë e Urbanizmit, Raportin e Inspektimit final të punëve dhe përshkrimit të dokumentacionit, hartuar nga ekipi profesional i Drejtorisë së Inspektionit të Komunës së Prishtinës.

Me kërkesë, investitori ka prezantuar dokumentacionin sipas Shtojca 5 të e Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit:

- Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit shtojca 2 dhe 4/a deri 4/f.
- Vendimin nr. 05Nr.351/02-0208312/17 dt. 06.02.2018 për lejimin e ndërtimit të ndërtesave shumë banesore me afarizëm, përkatësisht Ndërtesa “R9/01” me etazhitet -4B+P+7, Ndërtesa “R9/02” me etazhitet -4B+P+10, Ndërtesa “R9/07” me etazhitet -2B+P+10, Ndërtesa “R9/08” me etazhitet -2B+P+6 dhe garazha “G1/G2” Bodrumi -3 & “G1/G2” Bodrumi -4 në parcelën nr. 1608-3, ZK Matičan.

- ndërtimit dhe taritën për ndikimet nga rritja e densitetit të infrastrukturës.
- Vendimin nr. 05Nr.351/02-0208312/17 dt. 24.07.20 për ndryshimin e vendimit të lejes ndërtimore.
- Informim mbi caktimin e adresës për objektin me nr. të referencës 05-015/02-266817/22 dt. 21.02.2023, Rr. "Beteja e Loxhës" me numrat e hyrjes/daljes 29, 31, 33, 35, 37, 39, 41, Rr. "Çuka" me numrat e hyrjes/daljes 26, 28, 30, 34, 36, 38, 40, dhe Rr. "Lavdie Lusha" me numrat e hyrjes/daljes 2, 4, 6, 8, 10, 12, 14.
- Raportin e mbikëqyrjes profesionale për secilën nga fazat e projektit si dhe raportin e udhëheqësit të punishtes, Arban Limani idn - udhëheqës e vendndërtimit, Arbnora Aliçkaj ida dhe Ahmet Mehmeti ida - mbikëqyrës për arkitekturë, Fatmir Veseli idn dhe Faton Grajçevci - mbikëqyrës për strukturë, Arban Shala idh - mbikëqyrës për hidro-instalime, Osman Mehmetukaj ide - mbikëqyrës për instalime elektrike, Gazmend Krasniqi msc dhe Agron Zuka idm - mbikëqyrës për instalime makinerike, Arban Shala - mbikëqyrës për instalimet për mbrojtje nga zjarri.
- Incizimin gjeodezik të objektit, dhe rregullimit të jashtëm-gjendjen e realizuar, me vijën rregullative dhe vijën ndërtimore e vendosur në sistemin koordinativ sipas Kosovaref 01, nga gjeodetja e licencuar Edona Sheqerolli me nr. të licencës 101 dhe kompania e licencuar "GES Plan" sh.p.k. me nr. të licencës 46.
- Protokollet e miratuara për te gjitha fazat e ndërtimit,
- Atestet e materialeve dhe rezultatet e testimeve,
- Fotografi gjatë procesit të ndërtimit,
- Kopjet e diplomave të inxhinierëve mbikëqyrës të objektit,
- Çertifikata e pronës dhe kopja e planit

Drejtorja e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, pas shqyrtimit të kërkesës, provave të lëndës, konkretisht Njoftimit mbi Inspektimin Final të ndërtimit të ndërtesave i prezentuar nga Drejtoria e Inspektionit Sektori i Ndërtimit, me referencë 09 Nr. 391/02-228921/21 dhe 09 Nr. 391/02-228921/21/1 dt. 11.05.2022, dhe pas dorëzimit të dokumentacionit nga ana e investitorit, përmes kërkesës 05 Nr. 391/02-127693/22 dt. 06.06.2022, ka konstatuar se:

Në raportet përfundimtare të inxhinierëve mbikëqyrës fazave të ndërtesave: arkitekturë, strukturë, instalimet e ujësjellësit dhe kanalizimit, instalimet elektrike, instalimeve makinerike, mbrojtjes nga zjarri dhe punëve zeytare si dhe matjeve gjeodezike, konstatohet se ndërtesa është realizuar në përputhshmëri të plotë me Ligjin e Ndërtimit Nr. 04/L-110, projektin kryesor, Lejen ndërtimore 05Nr.351/02-0208312/17 dt. 06.02.2018. Po ashtu theksohet se punët janë zhvilluar në harmoni me projektin kryesor, si dhe me normat dhe standardet në fuqi, gjegjësisht ndërtesat shumë banesore me afarizëm, mund të përdoren.

Në Njoftimin mbi inspektimit final të lëshuar nga Drejtoria e Inspektionit-Sektorit i Ndërtimit, është konstatuar se të gjitha punimet në ndërtesa janë të përfunduara, dhe se udhëzohet pala që të vazhdojë procedurat për pajisje me certifikatë të përdorimit. Po ashtu edhe kërkesat që dalin nga Ligji për Ndërtim Nr.04/L-110, neni 27, janë të aprovuara nga ana e Mbikëqyrjes Profesionale të angazhuar nga ana e Poseduesit të Lejes Ndërtimore.

Kjo drejtori, bazuar në raportet e prezantuara dhe konstatimet e lartcekura, vendosi që ndërtesat shumë banesore me afarizëm, me etazhitet -4B+P+7, -4B+P+10, -2B+P+10, -2B+P+6, mund të përdoren/shfrytëzohen, gjegjësisht të lëshojë certifikatën e përdorimit për këto ndërtesa.

Bazuar në konstatimet e më sipërme u vendos si në dispozitiv të kësaj Certificate.

Udhëzimi juridik: Pala e pakënaqur me këtë Certifikatë, me ankesë mund ti drejtohet kësaj drejtorie brenda afatit prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të kësaj Certificate. Bazuar në vlerësimin nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror – MMPHI-ja.

I dorëzohet: Kërkuesve/Investitorit, Drejtorisë së Kadastrit, Drejtorisë së Inspektionit, kësaj drejtorie, Qendrës për shërbim me qytetarë dhe në dosje të lëndës.

**DREJTORIA E URBANIZMIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS,
05 NR. 391/02-127693/22 DT. 06.03.2023**


Zyrtari:

Arbër Morina



Udhëheqëse e sektorit

Nazife Krasniqi



Faqe 2 prej 2



Drejtori:

Arbër Sadiki